



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 25 shkurt 2026, në mbledhjen e II-të (dytë) -e jashtëzakonshme, mandati VIII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Isak Shabani, Haki Rudari, Artrit Mulliqi, Adelinë Stublla, Qëndresë Hajrizi, Alisa Jetullahu, Enis Shabani, Ekrem Rrahmani, Mimoza Abdullahu), lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës.

Rendi i ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, ju e keni marrë materialin për këtë mbledhje të jashtëzakonshme ku i kemi vetëm dy pika të rendit të ditës, -Propozim vendimi për përfaqësimin e Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, -Propozim vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me këto pikat e rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta është dashur të kemi më shumë shpjegim se ndryshe po vijnë dokumentet e ndryshe po veproni në seancë, letrën që e ka dërguar i nderuari Sazan Ibrahimimi dhe e ka cek qysh ndahen vendet për delegatët e Asociacionit, nga ti kërkoj ta di qysh ka me ndodh kjo ndarje e mos të dalim pastaj të shtyhemi në seancë e të themi ne na takon një anëtar ose dy anëtarë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e kemi pikën e radhës për të cilën do të diskutojmë se sa do të jetë numri i anëtarëve të përfshirë në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës, prandaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim rendin e ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njësëri me 8 vota Për u miratua rendi i ditës sipas shkresave dhe materialit përkatës.

1. Propozim Vendimi për përfaqësimin e Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës - AKK

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani jua jap fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, në bazë të Shkresës së AKK-së e dimë që Komuna jonë përfaqësohet nga Kryetari i Komunës si dhe për çdo 10 anëtarë të Kuvendit, Komunitat i delegojnë nga 1 përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, do të thotë kërkohet përfaqësimi i partive politike përfshirë këtu edhe përfaqësimin gjinor. Pra gjithsej janë 5 anëtarë/e prej tyre 4 anëtarë/e zgjidhen nga radhët e Kuvendit, andaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e hapim diskutimin.

z.Haki Rudari, theksoi, ne kemi propozim vendimin për përfaqësimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës në Kuvendin e AKK-së, realisht unë e kam edhe Statutin e Asociacionit në fjalë ku në bazë të cilit parashihet përfaqësimi i çdo Kuvendi Komunal në Kuvendin e AKK-së. Po ashtu Shkresa e cila na ka ardhë neve nga Bordi i këtij Asociacioni ndër të tjera shkruhet se përveç Kryetarit të Komunës, Komuna delegon edhe 4 anëtarë të Kuvendit, nga një përfaqësues, e që në rastin tonë Komunës i takojnë 4 anëtarë për arsye se 3.5 llogariten 4 anëtarë/e, dhe po ashtu duhet të bëhet përfaqësimi i partive politike dhe përfaqësimi gjinor.

Përfaqësimi i partive politike kërkohet në bazë të numrit të votave të partive që kanë në Kuvendin Komunal, pra përfaqësimin e votave dhe ne ndryshimin e votave nuk mund ta bëjmë në asnjë votë edhe përkundër dëshirës së dikujt ai përfaqësim i cili ka ardhë zyrtarisht, ai përfaqësim mbetet deri në përfundim të këtij mandati. Prandaj ne si Grup e përkrahim, KPF-ja nuk ka të drejtë të merr vendime prandaj vetëm rekomandon, andaj ne Grupi i LVV-së rekomandojmë që në seancë të diskutohen edhe modalitetet tjera si tek ndarja e vendeve ashtu edhe tek përfaqësimi gjinor, mirëpo të gjitha këto duke u bazuar në fuqinë politike dhe pastaj natyrisht kjo në fund vendoset përmes votimit duke u bazuar edhe në Shkresën e dërguar nga Bordi i AKK-së, konkretisht nga Sazan Ibrahimiq që është Drejtor Ekzekutiv.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kolegun z.Haki Rudari e falënderojmë për sqarimet që bëri, unë them se kolegu i ka munguar herën e kaluar këtij Kuvendi sepse e kemi pasë të njëjtin problem për këto ndarje të vendeve, e saktë është ashtu siç e tha dhe e ka cek njëri prej pikave që thotë se Komunitat do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Komunës në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal. Kjo kurrfarë filozofie nuk do, ndahen vendet ashtu siç janë marrë votat dhe nuk e qesim keq as pozitën e as opozitën, pse të dalë gjithë opozita për çdo vendim të votoj kundër, për çka kundër, sepse i mohohet një e drejtë edhe pse këta anëtarët e Kuvendit shkojnë në atë përbërje dhe dihet që kompetenca atje i takon Kryetarit të Asociacionit që ka marrë më së shumti vota nga komunitat, dhe s'është ndonjë kompetencë shtesë për të mos thënë zero ndikim ka anëtar i Kuvendit atje, e them këtë sepse nuk kemi nevojë të shtyhem në seancë sa anëtar po i caktojmë ne ose ata.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë pajtohem të shkojmë drejtpërsëdrejti në Kuvend, dhe kjo vetëm për t'ia lehtësuar punën Kuvendit, por nëse ne sot si KPF bëjmë propozime e që është më e lehtë që fillimisht të përcaktohem edhe për përfaqësimin gjinor në mënyrë që të mos na zgjatin shumë pastaj në Kuvend diskutimet, andaj unë mendoj që së pari të bisedojmë sot në KPF dhe nëse kemi harmonizim të qëndrimeve të vazhdojmë mandej me këto rekomandime, nëse jo atëherë në takimin e nesërm Kuvendi vendos. Pra njëherë t'i marrim mendimet rreth përcaktimeve dhe përfaqësimin gjinor në mënyrë që ta kemi një konstatim të përbashkët për rekomandim Kuvendit në mënyrë që të mos zgjatin debatet shumë në Kuvend.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë rekomandim nuk po jap por mënyra qysh ndahen, tabelën e kam, tash a e pëlqejnë apo jo, ajo është tjetër gjë, këtu në bazë të numrave që janë aktual në Kuvend janë 4 përfaqësues, LVV-së i bie t'i ketë 2 përfaqësues dhe LDK-së i bie t'i ketë 2 përfaqësues, subjektet tjera nuk kanë përfaqësues, pastaj kemi edhe ndarjen në bazë të kuotës gjinore e që duhet të shkoj një me një, por kemi partinë në pushtet që ka numra pak më shumë dhe nuk e di qysh do të veprojmë, mirëpo formulën e ndarjes unë e kam.

z.Haki Rudari, theksoi, kolegu z.Ekrem Rrahmani tha që herën e kaluar unë kam munguar, po ashtu është sepse më është dashur të udhëtoj në Gjermani, besoj e dini që unë kam pas rast familjar, pra kam pas rast vdekje dhe për këtë arsye kam munguar.

Unë thash që ne s'kemi të drejtë të marrim vendime por vetëm të rekomandojmë, diskutojmë dhe debatojmë, por s'ka kurrfarë problemi, në bazë të kësaj që parashihet dhe në bazë të numrave Komunës së Podujevës i takojnë 4 anëtarë/e nga Kuvendi, prej tyre LVV-së i takojnë 2 anëtar në bazë të përqindjes dhe fuqisë që ka në Kuvendin Komunal për arsye se në mënyrë matematikore i bie 1.7% e që i bie 2 përfaqësues. Në këtë mandat unë mendoj se përfaqësimi partive politike u takon në bazë të përqindjes që kanë, pastaj LDK ka 1.4% e që i bie 1 përfaqësues.

Mandej thënë të drejtën, prej vitit 2013 që unë kam qenë përfaqësues / delegat në AKK, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ka qenë në këtë përbërje edhe pse në dokumentin/shkresën përkatëse nuk parashihet në mënyrë automatike, megjithatë është kolegji i Kryesuesve të Kuvendeve që formohet prej Kryesuesve dhe duhet çdo herë që çdo Komunë ta ketë Kryesuesin e Kuvendit përfaqësues.

Në këtë rast unë mendoj që formula duhet të jetë 2+1+1, do të thotë 2 përfaqësues nga LVV, 1 përfaqësues nga LDK dhe Kryesuesi i Kuvendit në këtë rast, sigurisht po të mos ishte Kryesuesi në këtë rast do të ishte pak më ndryshe, prandaj po e them edhe njëherë se nuk është e hijshme që Kuvendi i Komunës së Podujevës të shkoj atje pa përfaqësues Kryesuesin e Kuvendit të Komunës.

Ndërsa sa i përket aspektit gjinor, nga LVV do të propozohen nga një prej dy gjinive, por nuk e di sakt në këtë përbërje prej 4 anëtarëve a mjafton me qenë vetëm një femër anëtare.

Kjo është fuqia e partive politike, e thash në fillim se nuk mund ta ndryshoj askush dhe në këtë duhet të bazohemi unë dhe secili, dhe në bazë të kësaj pasqyre të bëhet votimi dhe të jetë shumë kolegial për arsye se po përfaqësohen 3 partitë më të mëdha në Kuvendin e Komunës. Pra kjo është formula dhe ne e përkrahim në emër të Grupit.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, propozimi i parafolësit z.Haki Rudari duket të jetë subjektiv, gjithashtu edhe unë mendoj se do ishte mirë që të ishte edhe Kryesuesi i Kuvendit, besoni që nuk e them në atë kuptimin që dua të jem edhe unë në atë përbërje, por në bazë të asaj që unë e di se duhet të ketë koordinim dhe se do të ketë vetëm një mbledhje brenda një dite sepse ka shumë punë brenda Asociacionit të Komunave, megjithatë kjo është shumë e rëndësishme sepse aty ngritën shumë çështje të cilat prezantohen te niveli qendror dhe nëse nuk gabohem herën e kaluar nuk ka qenë përfaqësuesi i LDK-së fare dhe tani është shumë mirë që LDK-ja do të ketë përfaqësues, andaj nëse pajtoheni ta mbështesim propozimin e z.Haki Rudari si rekomandim për Kuvend me formulën 2+1+1, normalisht duke respektuar përfaqësimin gjinor.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk është diçka që dua ta cekë, por është një gabim teknik në material të faqja e parë në kllapa ku e keni shënuar e keni shënuar "bashkangjitur shkresa e ASK-së", ASK do të thotë Agjencioni i Statistikave e që s'ka të bëjë asgjë me këtë, kurse kjo është AKK, pra duhet të bëhet ky përmirësim sepse pastaj materiali po del në ueb faqe e tani vetëm po bëhemi bizarë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, pajtohemi që gabimet e mundshme duhet të përmirësohen. E vë në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit si materia e dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe duke përfshirë edhe propozimin e parafolësit për të cilin pati dakordim nga të gjithë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e caktuar të mbahet më 26 shkurt 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me konstatim të theksuar që përbërja dhe formula e ndarjes së vendeve në përbërjen e përfaqësimit të Komunës së Podujevës në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës, të jetë si në vijim:

-Kryetari i Komunës

-Kryesuesi i Kuvendit

-Dy (2) Përfaqësues nga radhët e LVV-së

-Një (1) Përfaqësues nga radhët e LDK-së

Si dhe duke pasë parasysh edhe përfaqësimin gjinorë.

2. Propozim Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, theksoi, duke e paraqitur fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, Komuna e Podujevës është në proces të themelimit të përbërjes së KKSB-së dhe thirrja publike për propozime ka filluar prej datës 16 deri 30 janar në mënyrë që grupet e përfshira sipas Udhëzimit Administrativ të aplikojnë. Në shumicën e kategorive është propozuar nga një përfaqësues, mirëpo në 3 kategori nuk kemi përfaqësues, do të thotë i kemi nga 2 përfaqësues që duhet të votohen prej asamblesë komunale. Një kategori nuk kanë dërguar përfaqësues dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ kur ndonjë komunitet nuk dërgon përfaqësues atëherë Kryetari i Komunës në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ përkatës ka të drejtë që në konsultim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK të caktoj një përfaqësues, dhe në këtë rast e ka dërguar Sevdije Mustafën përfaqësuese të Komunitetit Egjiptas.

Tani mund t'i lexoj emrat për secilin anëtar/e të KKSB-së: me automatizëm është Kryetari i Komunës që është Shpejtim Bulliqi i cili është edhe Kryesues i Këshillit; Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë; Mensur Hoti përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame Podujevë; Gjergj Uka përfaqësues i Kishës Protestante Ungjëllore në Podujevë; përfaqësues i Komunitetit Ashkali që janë dy kandidat, Xhafer Ademi dhe Fitim Sejdiu ku njëri prej tyre duhet të zgjidhet me vota në Kuvend; mandej kemi Enver Rama përfaqësues i Komunitetit Rom; Sevdije Mustafa përfaqësuese e Komunitetit Egjiptas që ka ardhë si propozim i Kryetarit për arsye se Komuniteti Egjiptas nuk ka propozuar përfaqësues e që në bazë të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ Kryetari i Komunës në konsultim me ZKKK e cakton një përfaqësues: mandej kemi edhe Kryesuesin e Komitetit për Komunitete i cili vie me automatizëm dhe i bashkëngjitet/inkorporohet këtij Këshilli; Naime Podvorica zyrtare për barazi gjinore, Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; Nazif Sheqa kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Podujevë; Ymerdin Hasani përfaqësues i FSK-së; Qefser Behrami përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; Naim Bajrami përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; Grani Thaçi Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi; Bahri Selimi përfaqësues i Emergjencave Civile; Liman Zeqiri përfaqësues ZKKK; Sabrie Bislimi përfaqësuese e OJQ-ve, dhe kemi dy propozime për përfaqësues të Mediave për të cilët pritet që ju nesër në Kuvend të votoni për njërin prej tyre që janë Rozafat Maloku

dhe Enit Veliu; si dhe kemi përfaqësuesit e komunitetit të Bizneseve që po ashtu janë dy propozime Afrim Fazliu dhe Esad Kamerolli që duhet të votohen në Kuvend për njërin prej tyre; si dhe është Idriz Hoxha përfaqësues i komunitetit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, tash po e dimë se në bazë të Udhëzimit Administrativ për KKSB, kemi emrat që u lexuan nga Nënkryetari i Komunës, do të thotë kemi edhe 3 propozime që në Kuvend paraprakisht duhet të votohen si përfaqësues të secilit komunitet apo subjekt, e në këtë rast te komuniteti Ashkali kemi 2 kandidat ata janë Xhafer Ademi dhe Fitim Sejdiu e që paraprakisht do të votohen për këta se cili do merr shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit, pastaj kemi edhe përfaqësuesit e Mediave Lokale Rozafat Maloku dhe Enit Veliu dhe po ashtu cili prej tyre të merr vota më shumë do të jetë përfaqësues, mandej po ashtu kemi dhe nga komuniteti i Biznesit që janë Afrim Fazlija dhe Esad Kamerolli, pra ne paraprakisht do t'i hedhim në votim këto tri propozime me nga dy të propozuar, dhe pastaj në bazë të votave të tyre, do të votojmë për themelimin e KKSB-së përfshirë edhe listën/emrat e gjithë anëtarëve të KKSB-së.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Udhëzimi Administrativ që e ceku Nënkryetari i Komunës, te përbërja e KKSB-së, Kryetari i Komunës është, pastaj nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare në komunën përkatëse, por pika 1.14 thotë, një përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit, pra që të tria këto e kanë veç një përfaqësues, kurse ju po doni t'i bëni tre përfaqësues në këtë rast, e kjo është gabim. Pra përfaqësues të OJQ-ve e kemi Sabrie Bislimi e që pika 1.14 thotë një përfaqësues prej OJQ-ve, Biznesve dhe Mediave, pra të gjitha këto e kanë vetëm një përfaqësues.

Unë e di që të gjithë kanë dëshirë të jenë të përfaqësuar këtu por prej të gjithë këtyre vetëm një anëtar duhet të jetë përfaqësues.

z.Fahri Restelica, Nënkryetar i Komunës, theksoi, është e vërtetë që Udhëzimi Administrativ e thotë një përfaqësues nga OJQ-të, Mediat Lokale, Komiteti i Biznesit dhe Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara, mirëpo është marrë një praktikë edhe prej komunave tjera që me pasë përfaqësim sa më të mirë dhe sa më dinjitoz për të gjitha këto komunitete që janë këtu, për këtë arsye e kemi zgjedh nga një përfaqësues dhe besoj që nuk paraqet kurrfarë problemi që të ketë një përfaqësim sa më të mirë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nëse thirrsh në Udhëzim Administrativ dhe në këtë pikë e tejkalon një përfaqësues sepse i bie të jenë 4 përfaqësues, kurse pikat tjera janë në rregull. Nuk e them unë që duhet me dalë jashtë kësaj, por Udhëzimi Administrativ e thotë ashtu, ka pika që cekën ku duhet të jetë vetëm një përfaqësues, mirëpo te kjo pikë thuhet një përfaqësues nga OJQ e të tjerat që u cekën, pra i bie që këta duhet të merren vesh mes veti se kë po e sjellin si përfaqësues të tyre, por edhe nëse e zgjerojmë këtë, nuk them që nuk duhet të ketë përfaqësues më shumë por them që duhet të respektohet Udhëzimi Administrativ, ndërsa sa i përket praktikave prej komunave tjera që u tha, nuk e di pse duhet të merren ato kur është Udhëzimi Administrativ, kjo Zyra ligjore se di pse po vepron kështu, pse me marrë praktika të Komunës së Hanit të Elezit ta zëm, e kemi Komunën tonë, i kemi Udhëzimet Administrative.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, mirë është i nderuar Ekrem, mendoj se me këtë çështje duhet të merret Zyra ligjore dhe Nënkryetari i Komunës. Në Udhëzimin Administrativ ashtu shkruan por në bazë të asaj që tha Nënkryetari i Komunës nuk shohim ndonjë problematikë që të kemi përfaqësim sa më të madh në KKSB, pse jo të kemi të përfaqësuar sa më shumë dhe nuk i ikim kësaj formule, mirëpo nëse rastësisht ka kontestim kjo çështje shkon edhe në Ministrinë përkatëse e cila na jep rekomandimin. Tek ne si Kuvend kanë ardhë këto propozime që janë dhe në bazë të asaj ne nuk po i anashkalojmë pasi që kanë ardhë si propozime dhe do të thoja që këtë ta hedhim në votim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kam edhe disa pyetje te kjo pika e KLSP-ve ku është Qefser Behrami përfaqësues i KLSP-Kërpimëh e i ka qenë edhe herën e kaluar përfaqësues e besoj që ka certifikat sepse duhet të jetë i certifikuar, mirëpo dëshiroj ta shohë dokumentacionin për këtë Naim Bajramin.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së i rekomandojmë Kuvendit për themelimin e KKSB-së.

z.Isak Shabani, Kryesues i Komitetit, theksoi, tani e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me konstatim të theksuar që në përbërjen e anëtarëve të propozuar sipas numrave rendor 5; 19; 20 të propozim vendimit ku janë propozuar nga dy (2) anëtar, për secilin të votohet veç e veç sa i përket përcaktimit në kuadër të përbërjes së KKSB-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, kjo pikë e rendit të ditës rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e caktuar të mbahet më 26 shkurt 2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, me konstatim të theksuar që në përbërjen e anëtarëve të propozuar / nominuar sipas numrave rendor 5; 19; 20 të propozim vendimit ku janë propozuar nga dy (2) anëtar, për secilin të votohet veç e veç sa i përket përcaktimit në kuadër të përbërjes së KKSB-së.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;
Enis Sheholli
Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/0411543/26
Podujevë,
25 shkurt 2026

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Isak Shabani